

**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE**

**TIRANE ALBANIA**

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**

**DHE**

**PASQYRA E FONDEVE TE PERFITUARA DHE**

**SHPENZIMEVE TE KRYERA**

**GJATE FUSHATES ZGJEDHORE**

**PER PERIUDHEN**

**23 MAJ 2013 - 23 QERSHOR 2013**

**Tirane,me 15 Tetor 2013**

## **PERMBLEDHJE E LENDES**

- Raporti i Audituesit te Pavarur
  
- Shenime mbi Deklaratat Financiatre
  - I Te pergjithshme
  
  - II Politikat operuese
  
  - III Regullat e Vleresimit
  
  - IV Te ardhurat
  
  - V Shpenzimet

## RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAU

**Drejtuar :** -Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

(Bulevardi: “Dëshmoret e Kombit” Pallati i Kongreseve,

Tirane

-Partia Socialiste e Shqiperise

Sheshi “Austria”

Tirane

### **Te nderuar Zoterinj:**

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”i ndryshuar, ne zbatim te Vendimit te KQZ Nr. 752 date 02/08/2013 si dhe Kontraten e Sherbimit Nr.6673 date 02/09/2013 te lidhur me kete institucion ne cilësinë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushaten zgjedhore, që fillon me datë 22.05.2013 me regjistrimin e Partisë Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 22.06.2013 me përfundimin e fushates zgjedhore të 23 Qershor të vitit 2013.

### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi mban pergjegjesi per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Ligjin Nr. 10019, date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise” dhe Ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” date 29.04.2004. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazen e arketimeve dhe pagesave.

### **Pergjegjesia e Audituesit**

Pergjegjesia e jone eshte qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazen e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të

ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Ne çmojme se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Pasqyra e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste që fillon me datë 22.05.2013 dhe mbyllet me datën 22.06.2013 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

### **Opinion**

Sipas opinionit tonë, bazuar në auditimin e kryer, me siguri të arsyeshme, shprehim opinionin se Pasqyrat Financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste që fillon me dt.22.05.2013 dhe mbyllet me datën 22.06.2013 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arkëtimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” duke dhënë një një **pamje të vertete dhe të sinqerte.**

### **Per “LIRENG Auditing” Shpk**

Neshat MAZE

### **Ekspert Kontabël i Regjistruar**

Lic.148. date 21/07/2006

Tirane, me 15 Tetor 2013

## **I - Te Pergjithshme**

### **Baza ligjore e kryerjes se ketij misioni**

- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.8580, dt.17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar me ligjin Nr.10374, date 10.02.2011.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare,,
- Çdo dokument ligjor të marrë prane Partisë Socialiste te Shqiperise.

### **Te pergjithshme mbi Subjektin Zgjedhor**

Partia Socialiste e Shqiperise sipas dokumentacionit te Zyres se Regjistrimit te Partive Politike, prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, rezulton se me urdher nr. 36/1 date 15.08.1991 te Ministrit te Drejtesise eshte miratuar krijimi i Partise “Partia socialiste”, me iniciale “PS” ose “PSSH”. Kryetar i saj eshte Zoti Edi RAMA.

Qellimi dhe objektivat e kesaj partie jane te percaktuara ne program dhe statutin e saj.

### **Organizimi dhe drejtimi**

Instancat dhe organet qendrore te PSSH jane:

- Kongresi i Partise
- Asambleja e Kmbetare
- Kryesia e Partise
- Kryetari i Partise

Gjithashtu ne statut jane percaktuar edhe organet drejtuese te partise ne rrethe

- Keshilli Koordinuar i Partise ne Qark
- Asambleja Socialiste e Rrethit
- Kryetari i Partise i Rrethit
- Asambleja Socialiste e Bashkise/Komunes
- Kryetari i Partise i AS te Bashkise/Komunes

### **Burimet e financimit te Partise jane:**

- Te ardhurat nga kuotizacionet;
- Te ardhurat nga buxheti i shtetit ne perputhje me ligjislacionin per financimin e partive politike;
- Ndhimat dhe dhuratat e antaresise dhe te perkrahesve te PSSH;
- Çdo e ardhur tjeter qe nuk bie ne kundërshtim me ligjislacionin per financimin e partive politike.

**Selia e Partise** eshte Sheshi “Austria” - Tirane

## **II - Politikat operuese**

Drejtimi i Partise, ka operuar per kete periudhe qe auditojme ne ne pajtim me ligjin 10019, date 29.12.2009 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, ligjin 8580 date 17/02/2000 “Per partite politike” i ndryshuar, dhe ligjin Nr.9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i dates 29.04.2004, dhe ne konformitet me aktet nenligjore, me objektin e veprimtarise per te cilin eshte krijuar, dhe programit te caktuar nga organet qendrore.

## **III. Rregullat e vleresimit**

### **Menyra e pergatitjes se Pasqyrave Financiare**

Gjendja u pergatit me qellimin per te raportuar tek Komisioni Qendror Zgjedhor , per fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera. Kontabilitetit eshte ndertuar mbi bazen e parimeve te konstatimit. Sipas kesaj menyre fondet e perfituara ne te holla jane rregjistruar ne momentin e arketimit te tyre dhe fondet e perfituara ne natyre dhe sherbimet ne momentin e kryerjes duke i konvertuar ne leke me cmimin e tregut dhe shpenzimet jane pasqyruar ne momentin e konstatimit te tyre kur jane kryer. Administrimi i fondeve te perfituara dhe shpenzimet e kryera jane te perqendruara ne Selin e Partise Socialiste ne Qender.

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare,, dhe Planin Unik Kontabel, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Rregullat për vleresimin e kërkesave për arkëtim dhe të detyrimeve.Kërkesat për arkëtim janë të pasqyruara mbi bazën e vlerës së faturave origjinale të lëshuara nga klientet apo të dokumentave të tjerë kontabël. Detyrimet janë njohur dhe pasqyruar

mbi bazen e faturave dhe dokumentave orgjinale kontabël.

- Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve. Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.
- Të Ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.
- Monedha e raportuar: Drejtimi financiar i Partise ka perdorur si monedhe baze raportimi monedhen kombetare Leke. Fondet e perfituara dhe shpenzimet e kryera jane mbartur ne dokumentacionin fillestar ne monedhat All, Usd dhe Euro ose ne kontribute ne natyre. Gjendjet jane pergatitur ne Leke. Fondet dhe shpenzimet e emetuara ne monedha te huaja jane konvertuar ne Leke, bazuar ne kursin e kembimit te dates qe eshte kryer transaksioni, dhe donacionet ne natyre jane vleresuar ne Leke me cmimin e tregut ne momentin e perfitimit.
- Taksat dhe Kontributet: Partia eshte e perjashtuar nga taksat mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet qe lindin per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore te punonjesve dhe per Tatimin mbi te ardhurat personale.

### **Organizimi i Kontabilitetit**

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me Planin Unik Kontabël. Kontrolli i brendshem kryhet nga dega e finances. Kontabiliteti mbahet në program.

## SHENIME

### MBI DEKLARIMET FINANCIARE

#### PER FUSHATËN ZGJEDHORE PER ZGJEDHJET PER KUVEND 2013

Megjithëse fushata e zgjedhjeve për zgjedhjet per Kuvend 2013 ka filluar më 22 Maj 2013 dhe perfundoi më 22 Qershor 2013, aktiviteti financiar në shërbim të kesaj fushate shtrihet në një periudhë më të gjatë se sa ky kufi zyrtar.

Për Partinë Socialiste periudha financiare e fushatës zgjedhore shtrihet kryesisht në muajt Mars–Prill 2013, e cila vazhdon deri ne Shtator 2013 duke mospërfunduar as në këtë muaj pasi priten ngjarje të mëvonëshme për sigurimin e të ardhurave të tjera per të paguar shuma faturash të pranuar për shërbime të kryera nga disa media në shërbim të fushatës elektorale të Partisë Socialiste.

Bazuar në auditimin e kryer, rezulton se të ardhurat janë evidentuar e deklaruar në bazë të arkëtimeve faktike, pa përfshirë arkëtimet e pritëshme, duke zbatuar rregullisht parimin kontabël të kujdesit, ndërkohë që shpenzimet janë evidentuar e deklaruar në përputhje me parimin kontabel te angazhimeve sipas të cilit, ato përfshijnë të gjitha shpenzimet e kryera dhe të njohura pavarësisht në se janë paguar apo mbeten për t'u paguar në periudha të mëvonëshme.

Mbi bazen e ketyre parimeve të kontabilitetit, në llogaritë kontabile e në Pasqyrat financiare të Partisë Socialiste janë evidentuar e deklaruar si shpenzime për fushatën zgjedhore edhe faturat e pranuar por të papaguara ndaj furnitorëve të ndryshëm për shërbimet e përfituara gjatë fushtës elektorale veprime te cilat jane në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të dala në zbatim të tij.

Në këtë kuadër konceptual të të ardhurave e shpenzimeve , auditimi u shtri dhe mori në kosideratë edhe ngjarje e fakte ekonomike e financiare që i takojne fushatës zgjedhore të 23 Qershorit 2013, pavarësisht se ato kanë ndodhur edhe në periudha jashtë kufirit zyrtar të kësaj fushate.

Auditimi i situatës financiare të fushatës zgjedhore të Partisë Socialiste mori për bazë raportet financiare, regjistrat kontabile si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili na bëri të mundur krijimin e baze së opinionit të Audituesit të Pavarur për angazhime auditimi për qëllime të veçanta, në përputhje me SNA 800 , siç spjegohet në vijim.



#### IV TE ARDHURAT

Bazuar ne auditimin e kryer rezulton se te ardhurat per fushaten elektorale te Partise Socialiste, sipas burimit te financimit te tyre ,klasifikohen si vijon:

PASQYRA E TE ARDHURAVE TE PARTISE SOCIALISTE PER FUSHATEN ZGJEDHORE 23MAJ-23 QERSHOR 2013					
Nr	Burimet e Financimit	Sipas raportit financiar	Sipas auditimit	Diferenca	Pesha specifike
		Leke	Leke	Leke	%
1	2	3	4	5	6
1	Nga buxheti I shtetit	33,045,566	33,045,566	-	41.27
2	Nga fondet e vet Partise Socialiste	1,724,325	1,724,325	-	2.15
3	Nga Donatoret(sponsorizime)	45,308,650	45,308,650	-	56.58
	-me banke	40,397,170	40,397,170	-	
	-me arke	3,100,000	3,100,000	-	
	-ne natyre	1,811,480	1,811,480	-	
	Gjithsej te ardhura	80,078,541	80,078,541	-	100.00

Nga auditimin rezultoi se Të ardhurat e siguruara nga Partia Socialiste për të përballuar fushatën për zgjedhjet per Kuvend 2013 janë deklaruar gjithsej 80,078,541.00 Leke. Këto të ardhura janë krijuar nga tre burime të ligjshme, dhe konkretisht:

**1. Financime nga buxheti i shtetit për fushatën elektorale 26,114,596.00 Leke** ose 32.61 % te totalit të fondeve të përdorura për fushatën e zgjedhjeve per zgjedhjet per Kuvend 2013, zhvilluar më 23 Qershor 2013 te arkëtuar në datën 14.06.2013 në Degen e Bankes Credins në llogarinë me Nr.00000112879 të çelur posaçërisht nga Partia Socialiste për këtë fushatë zgjedhore.

**2. Fondet e vetë Partisë Socialiste 1,724,325.00 Lekë,** përbëjnë nje pjesë të burimeve të financimit të fushatës elektorale, duke zënë 2.15 % të të ardhurave gjithsej. Nga kontrolli i fluksit të parasë rezulton se Partia Socialiste në fillim të vitit 2013 ka trashëguar në llogaritë bankare të saj 1,194,245.00 Lekë, nga të cilat më 04.04.2013 kanë mbetur pa u shpenzuar 1,056,410 lekë. Gjithashtu, krahas të ardhurave të tjera nga veprimtaria e Partisë Socialiste, nëpërmjet llogarive bankare të saj, janë akorduar nga buxheti i shtetit sipas planit të financimit vjetor te partive politike edhe 6,930,970.00 Lekë me date 12.06.2013 dhe fondi i fushates prej 26,114,596.00 Lekë me date 14.06.2013 (shkresa Nr.9165/2 date 13.06.2013 e KQZ-së). Keto fonde në shumën 33,045,566.00 Lekë jane videntuar dhe deklaruar si e ardhur për të përballuar shpenzimet e fushatës elektorale për zgjedhjet per Kuvend 23 Qershor 2013, prandaj ky fond u përfshi në objektin tonë të auditimit.

**3.- Donacionet nga shtetas shqiptarë të ndryshëm,** për shumen totale 45,308,650.00 Lekë

përbëjnë burimin e tretë të krijimit të fondeve për fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste duke zënë 56.58 % të fondeve gjithsej të siguruara për fushatën zgjedhore. Janë gjithsej 50 dhurues fondesh, shtetas shqiptarë të cilët kanë sponsorizuar me shuma parash deri në 100,000.00 lekë për çdo rast për fushatën elektorale të zgjedhjeve për zgjedhjet për Kuvendin 2013 si vijon:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Leke	Dollar	Euro	Data e dhurimit	Llogarit ku janë derdhur parate
1	Brunilda Gjylameti	1.000.000			28.05.13	Cred.00288405
2	Rudolf Xhillari	1.000.000			28.05.13	Cred.00288405
3	Gent Tare	1.000.000			28.05.13	Cred.00288405
4	Te tjere antaresia	3.100.000			31.05.13	Cred.00288405
5	Ursi Manja	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
6	Ibrahim Lami	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
7	Illir Xhakolli	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
8	Illir Beqja	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
9	Ervin Bushati	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
10	Arben Mazniku	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
11	Dritan Dalipi	1.000.000			31.05.13	Cred.00288405
12	Besnik Bare	200.000			03.06.13	Cred.00288405
13	Valbona Doci	1.000.000			03.06.13	Cred.00288405
14	Merita Qato	1.000.000			03.06.13	Cred.00288405
15	Keti Bazhdari	1.000.000			03.06.13	Cred.00288405
16	Koli Bele	800.000			03.06.13	Cred.00288405
17	Alket Hysini	1.000.000			03.06.13	Cred.00288405
18	Arben Skendo	1.000.000			05.06.13	Cred.00288405
19	Artur Qirici	1.000.000			05.06.13	Cred.00288405
20	Indrit Tafani	1.000.000			05.06.13	Cred.00288405
21	Oltiana Shkurti	1.000.000			17.06.13	Cred.00288405
22	Glenci Luto	1.000.000			17.06.13	Cred.00288405
23	Kelvi Vako	890.000			17.06.13	Cred.00288405
24	Artan Matraku	600.000			17.06.13	Cred.00288405
25	Enkela Bomava	1.000.000			19.06.13	Cred.00288405
26	Fatbardha Sadikaj	200.000			19.06.13	Cred.00288405
27	Gent Gazheli	900.000			14.05.13	Cred.000112879
28	Florian Pullazi	400.000			14.05.13	Cred.000112879
29	Endrit Isufaj	400.000		1.800	31.05.13	Cred.000112879
30	Arben Ahmetaj	875.000			31.05.13	Cred.000112879
31	Adriano Jance	1.000.000			13.06.13	Cred.000112879
32	Alketa Hila		9.250.00		18.04.13	Cred.124755
33	Genta Lubonja		9.250.00		18.04.13	Cred.124755
34	Juli Hoxha		9.000.00		21.05.13	Cred.288407

LIRENG AUDITING SHPK  
RAPORT AUDITIMI PER FONDET DHE SHPENZIMET

35	Bedri Buzi		9.000.00		21.05.13	Cred.288407
36	Florian Pullazi		5.000.00		21.05.13	Cred.288407
37	Mimoza Hafizi		9.000.00		21.05.13	Cred.288407
38	Margarita Hysi		9.000.00		21.05.13	Cred.288407
39	Sat Vorpsi		9.000.00		21.05.13	Cred.288407
40	Suzana Hakrama		7.000.00		21.05.13	Cred.288407
41	Dhurata Isufaj		630.00		21.05.13	Cred.288407
42	Vjola Sterjo			7.100.	08.04.13	Cred.456908
43	Julinda Dharmo			7.100.	08.04.13	Cred.456908
44	Alfred Sadikaj			7.100.	08.04.13	Cred.456908
45	Kristaq Tile	500.000			04.06.13	BKT401273430
46	Gezim Kopo	300.000			04.06.13	BKT401273430
47	Vladimir Konomi	250.000			04.06.13	BKT401273430
48	Bledar Doraci	1.000.000			04.06.13	BKT401273430
49	Zenada Ilnica	300.000			04.06.13	BKT401273430
50	Fatmir Muca	250.000			04.06.13	BKT401273430
	Shuma	31.965.000	76.130	23.100		
	Shuma ne leke	31.965.000	8.298.170	3.234.000		
	Karburant Sponsorizim					
51	Frange Dorzi	984.500				
52	Luan Struçe	826.980				
	Shuma	1.811.480				

Nga verifikimi rezultoi se të gjithë dhuruesit kanë nënshkruar deklaratën e mospasjes konflikt interesi në përputhje me nenin 89 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Te gjithë këta dhurues janë evidentuar dhe deklaruar ne regjistrin e posaçëm , të mbajtur sipas formatit të miratuar me vendimin nr.266, datë 01.06.2009 nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Fondete prej 3,100,000.00 Leke te dhuruara nga anetarsia, dokumentuar hyrje ne arken e Partise , jane derdhur ne banke.

Në të gjitha rastet dhuruesit kanë respektuar kërkesën ligjore të Kodit Zgjedhor sipas të cilës dhurata nuk mund të jetë më shumë se 1,000,000.00 Lekë për çdo rast. Po ashtu, nga verifikimi rezultoi se të gjitha këto dhurime janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare nr. 00000288405, llogari e posaçme e çelur për fushatën elektorale te 23 Qershor 2013 nga Partia Socialiste pranë Bankës Credins dhe BKT ne llogarin bankare 401273430 si dhe janë deklaruar brënda afatit ligjor.

Gjithashtu ka deklaruar dhe sponsorizimet ne natyre nga 2 dhurues ne shumen 1.811.480 leke.

## V SHPENZIMET

Nga verifikimet e kryera rezultoi se shpenzimet për fushatën elektorale të Partisë Socialiste, te grupuara sipas natyres se tyre jane si vijon:

Nr	Grupet e shpenzimeve	Shuma ne leke		
		Sipas raportit financiar	Sipas auditimit	Diferenca
a	Shpenzime te paguara			
1	Reklama spote televizive	143,365,058.00	143,365,058.00	
2	Media ne Greqi	11,360,568.00	11,360,568.00	
3	Baner	3,600,000.00	3,600,000.00	
4	Flamuj dhe aksesori nga Kina	11,852,074.00	11,852,074.00	
5	Karburant	2,110,768.00	2,110,768.00	
6	Qera ambjentesh salla	2,370,000.00	2,370,000.00	
7	Konsulenca	7,874,686.00	7,874,686.00	
8	Kancelari,leter,fotokopje(mater. te #)	583,443.00	583,443.00	
9	Flet palosje	1,440,000.00	1,440,000.00	
10	Foni.ndricim	1,296,000.00	1,296,000.00	
11	Kerkes padi	264,150.00	264,150.00	
12	Te ndryshme	1,067,168.00	1,067,168.00	
	<b>Shuma e shpenzimeve</b>	<b>187,183,915.00</b>	<b>187,183,915.00</b>	
b	Shpenzime te papaguara			
1	Reklama televizive	106,409,373.00	106,409,373.00	
2	Sherbim fonie Prosound	696,000.00	696,000.00	
	<b>Shuma e shpenzimeve te papaguara</b>	<b>107,105,373.00</b>	<b>107,105,373.00</b>	
	<b>Gjithesej shpenzime te paguara</b>	<b>80,078,542.00</b>	<b>80,078,542.00</b>	

Shpenzimet e fushatës së Partisë Socialiste për zgjedhjet e 23 Qershorit 2013 janë deklaruar gjithsej 187,183,915.00 Lekë, nga të cilat deri në datën e hartimit të këtij Raporti janë paguar 80,078,542.00 Lekë dhe diferenca 107,105,373.00 Lekë, ndonëse është njohur si shpenzim , nuk rezulton që të jetë paguar brenda kësaj periudhe.

Nga verifikimet tona rezulton se këto shpenzime nuk e kalojnë kufirin ligjor të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Koha e kryerjes se shpenzimeve në përgjithësi përputhet me afatin zyrtar te fushatës zgjedhore, por një pjesë e tyre janë bërë para fillimit zyrtar të fushatës dhe një pjesë tjetër pas datës 23 Qershor 2013, në varësi nga koha e pranimit apo likuidimit të faturave për shërbimet e përfituara. Deklarimi i shpenzimeve eshte bere ne menyre korrekte.

Shpenzimet që, për shkak të mungesës së fondeve financiare, kanë mbetur pa u paguar përbëhen nga detyrime ndaj disa mediave të cilat kanë kryer shërbime reklamash gjatë fushatës zgjedhore. Këto shërbime të gjitha janë të dokumentuara te vertetuara me fatura tatimore me tvsh,e konkretisht:

Nr	Subjekti	Fatura		
		Numer serie	Date	Shuma leke
1	Top Channel	nr.834 dhe nr.835	22.06.2013	62,946,792.00
2	A1 Report	nr.70,nr71,nr.344,nr.348 dhe Tv.Ballkan nr.15	Qershor 2013	9,644,531.00
3	Vizion Plus	nr.208,nr209,nr.210,nr211	Qershor 2013	7,714,033.00
4	Ora News	nr.94,nr95,nr111,nr110,nr119	Qershor 2013	20,784,813.00
5	Chane 1	nr.05,nr.07	Qershor 2013	5,319,204.00
	<b>Shuma</b>			<b>106,409,373.00</b>

Në tërësi shpenzimet janë të dokumentuara me fatura tatimore apo mandat arkëtime të institucioneve buxhetore që nuk janë subjekte tatimore si dhe janë të evidentuara në pajtim me rregullat dhe standartet kontabile që zbatohen në Shqipëri.

Bazuar ne grupimin e shpenzimeve të deklaruar nga Partia Socialiste, me riklasifikimin e tyre sipas natyrës , grupet e shpenzimesh sa vijon rezultojne:

Ndryshimet në grupeve të veçanta të shpenzimeve janë pa efekte materiale në tërësinë e tyre dhe përfundimisht totali i shpenzimeve sipas auditimit është i barabartë me atë që ka deklaruar Partia Socialiste. Shpenzimet të klasifikuara nga ana jonë janë si vijon :

**1- Shpenzimet për Reklama televizive**, ne shumen 143,365,058.00 Lekë zëne pjesën kryesore ose 76.59 për qind të tyre. Nga këto, 36,955,685.00 Lekë janë likujduar ndërsa diferenca 106,409,373.00 Lekë ka mbetur pa u paguar për mungesë fondesh duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partise si Detyrime të Kërkueshme nga Furnitorët që do të shlyhen kur të sigurohen burime financimi.

Te detajuara sipas subjekteve mediatike këto shpenzime përbëhen nga shërbime të kryera prej:

<b>PASQYRA E SHPENZIMEVE PER REKLAMA</b>				
Nr.	Emertimi	Likujduar	Pa Likujduar	Totali shpenzimit
1	Top-Channel	17,640,792.00	62,946,792.00	80,587,584.00
2	A1 Report	8,025,843.00	9,644,531.00	17,670,374.00
3	Vizion Plus	3,542,182.00	7,714,033.00	11,256,215.00
4	News 24	5,146,868.00		5,146,868.00
5	Ora News	2,600,000.00	20,784,813.00	23,384,813.00
6	Chanel 1		5,319,204.00	5,319,204.00
	<b>Shuma</b>	<b>36,955,685.00</b>	<b>106,409,373.00</b>	<b>143,365,058.00</b>

Këto shpenzime janë kryer në bazë të kontratave të lidhura midis palëve dhe vërtetohen me fatura te rregullta tatimore. Nga verifikimi rezultoi se të gjitha faturat e likujduara që i përkasin këtij grupi shpenzimesh jane paguar vetëm nëpërmjet llogarive bankare.

**1.1- Shpenzimet për Reklama televizive ne medja te huaj** , ne shumen **11,360,568.00** Lekë konvertuar në 80,000.00 Euro (sipas kursit bankar në ditën e likujdimit) i janë paguar sipas Kontratës me Agjensin AVENUEC&WAdv Greece datë 14.06.2013 nëpërmjet llogarisë së Partise në Banken CREDINS nr.288408.

**2- Shpenzime per materiale publicitare dhe materiale te tjera** ne shumen 12,435,517.00 Lekë zënë 6.64 % te totalit te shpenzimeve gjithsej. Ne këtë grup shpenzimesh janë deklaruar ato per flamuj dhe materiale te tjera nga Kina per fushaten duke perfshire ketu dhe doganen dhe komisionet ne shumen 11,852,074.00 Leke dhe shpenzime te tjera materiale ne shumen 583,443 Leke Nga verifikimi rezultoi se keto shpenzime vërtetohen me fatura tatimore dhe jane paguar nëpërmjet llogarive bankare Bankës Kombëtare Tregtare dhe Bankës Credins.

**3- Shpenzimet për foni, ndricim** 1,296,000.00 Leke,nga te cilat rezulton qe te jene paguar vetem 600,000.00 Leke nepermjet bankes ndersa shuma 696,000.00 Leke jane shpenzime te papaguara për mungesë fondesh duke u evidentuar e deklaruar në Kontabilitetin e Partise si Detyrime të Kërkueshme nga Furnitorët që do të shlyhen kur të sigurohen burime financimi.

Nr.	Emertimi	Likujduar	Pa Likujduar	Totali shpenzimit
1	Sherbim fonie Prosound	600,000	696,000	1,296,000
	<b>Shuma</b>	<b>600,000</b>	<b>696,000</b>	<b>1,296,000</b>

**4- Shpenzimet per karburant** 2,110,768.00 Leke janë të dokumentuara me fatura blerje tatimore të lëshuara nga “Europetrol Durres Albania” sha. Pagesa e tyre eshte bërë nëpërmjet llogarive bankare.

**5- Shpenzimet per konsulence** 7,874,685.00 Leke, konvertuar në Euro (sipas kursit bankar në ditën e likujdimit) i janë paguar kompanise Kondiment Group GmbH sipas Kontratës datë 05 Janar 2013 nëpërmjet llogarisë së Partise prane deges se Bankes CREDINS.

**6- Shpenzimet për qera salle** 2,370,000.00 Leke nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime vërtetohen me dokumente me siguri të arsyeshme dhe janë likujduar kryesisht nëpërmjet llogarive bankare.

**7- Shpenzimet për kanceleri (fletpalosje dhe Shtypshkrime)** 1,440,000.00 Lekë , përbëhen kryesisht nga shpenzime per letër, bojë printeri, fotokopje, te cilat janë paguar nëpërmjet arkës. Nga verifikimi rezultoi se ato përgjithësisht janë të dokumentuara me fatura të rregullta tatimore.

**8-Shpenzimet per kerkesë padi** 264,150.00 Leke janë vërtetuar me mandat arketimet e lëshuara nga Gjykata e Apelit për të njejtën shume.

**9-Shpenzimeve te ndryshme** 4,667,168.00 Lekë ku përfshihen shpenzime për hapjen e mbylljen e fushatës, shpenzime internet,udhezues QV,djeta,banera ,telefon etj, të cilat nga verifikimi rezultoi se edhe këto shpenzime jane të dokumentuara , janë paguar kryesisht

nëpërmjet llogarive bankare si dhe për ato që janë kryer jashtë teritorit të Republikës së Shqipërisë. Deklarimi i tyre, me siguri të arsyshme, është i besueshëm

Perfundimisht, bazuar në auditimin e kryer, sipas Standartit Ndërkombëtar të Auditimit Nr.800 (për qëllime të veçanta) me siguri të arsyeshme, në Raportin e Audituesit të Pavarur kemi shprehur Opinionin se Pasqyra Financiare e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Fushatës Elektorale të Partisë Socialiste, jep një pamje të vërtetë e të sinqertë të të Ardhurave të Realizuara dhe të Shpenzimeve të kryera gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet për Kuvend 2013.

**Per “LIRENG Auditing” Shpk**

Neshat MAZE

**Ekspert Kontabël i Regjistruar**

*Lic.148. date 21/07/2006*

Tirane, me 15.10.2013